



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 19236 prot.

Shkodër, më 26.09. 2025

**VENDIM
Nr. 60, datë 25.09.2025**

**“MIRATIMI I NDRYSHIMIT TË RISHPËRNDARJES SË FONDIT TË ZËRAVE TË
SHPENZIMEVE KAPITALE TEK SHPENZIMET KORENTE BRENDA TË NJËTIT
PROGRAM PËR VITIN 2025”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 25.09.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 45 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar; udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër.

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të rishpërndarjes së fondit nga zëri i shpenzimeve kapitale të trupëzuara (llog. ek. 231) te zëri i shpenzimeve operative (llog. ek. 602), në programin AB141 “Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile”, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi	Artikulli 231 Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (investime)	Institucioni Likuidues
1	AB141 (kap.1)	Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	P.AB141.Q1.O2.A5 Kamera sigurie(CCTV) për ambiente publike dhe mirëmbajtja e tyre A.2-Furnizim vendosje kamera sigurie për ambientet publike	1,000,000 Lëke	Bashkia Shkodër
Totali				1,000,000	

Shtesë viti 2025

Nr	Nr. Programi	Programi	Aktiviteti/Emërtimi Shtesë	Artikulli 602 Mallra dhe Shërbime (Shpenzime Operative)	Institucioni Likuidues
1	AB141 Kap.1	Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile	P.AB141.Q1.O2.A1 Pajisje me uniforma për Policinë Bashkiake (shtesë) A. 1 Blerje uniforma	1,000,000	Bashkia Shkodër
			Totali	1,000,000	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 36 vota

Vota Pro 36
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 26.09.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj



KRYETAR
Oltion LULI



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al